



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 38
Prishtinë, më 19.01.2010, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Memli Krasniqi, Arsim Rexhepi, Donika Kadaj-Bujupi, Hestet Cakolli, Mark Krasniqi, Enis Kervan dhe Dragan Dimiq.

Emrat e të ftuarve dhe të pjesëmarrësve të tjerë: përfaqësuesi i UNDP-së, OSBE-së, NDI-së, përfaqësuesi nga presidenca dhe mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e kryesoi **Agim Veliu**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.12.2009**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës,**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.12.2009

Kryetari konstatoi se Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 14.12.2009, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës

Kryesuesi i Komisionit – Agim Veliu, tha se për arsye të caktimit të funksionit të tij të ri është hera e fundit që udhëheq mbledhjen e komisionit. Ai fillimisht, falënderoi anëtarët e komisionit për bashkëpunim korrekt dhe njëkohësisht uron që komisioni të vazhdojë punën e saj me sukses. **Kryesuesi** lidhur me këtë pikë të rendit të ditës fjalën ia dha raportueses së komisionit, Drita Kadriu.

Drita Kadriu, falënderoi kryesuesin për kontributin dhe angazhimin që ka dhënë si udhëheqës i komisionit.

Ajo theksoi se gjatë shqyrtimit të Projektligjit për Mërgatën e Kosovës, komisioni ka zhvillu dy aktivitete, në njërin është mbajtur Dëgjim publik në të cilin janë ftuar grupe të interesit, ambasadorë të Kosovës dhe të huaj dhe asociacione të tjera, disa nga ata kanë ofruar propozime me shkrim. Si aktivitet tjetër është organizuar grupi punues dhe janë proceduar amendamentet e komisionit. Ajo propozoi që komisioni gjatë leximit të Projektligjit për Mërgatën e Kosovës njëkohësisht të shqyrtojë amendamentet të cilat kanë dalë gjatë shqyrtimit të këtij P/ligji.

Heset Cakolli - ndau mendimin të bëhet unifikimi gjuhësor i fjalëve “zbaton dhe monitoron” dhe propozoi që këto shprehje të standardizohen me Ligjet e miratuara në Parlament dhe njëkohësisht përkrah amendamentet e P/ligjit.

Mark Krasniqi, përkrah miratimin e amendamenteve të Projektligjit për Mërgatën e Kosovës me disa ndryshime të shprehjeve gjuhësore.

Memli Krasniqi, ai propozoi që në amendamentin 2, të nenin 6.1.1, të fshihet fjala “dhe monitorim”. Në bazë të amendamentit 5, propozoi që fjala ‘relevant’ të zëvendësohet me fjalën ‘përkatëse’. Këto propozime u miratuan nga komisioni.

Arsim Rexhepi, ai theksoi se qëllimi i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës është se me këtë projektligj Kosova do të rregullojë çështjet që kanë të bëjnë me Mërgatën e Kosovës, si dhe krijohet baza ligjore për themelimin e Agjencisë për Mërgatën e Kosovës. Lidhur me amendamentin 8, propozoi që Drejtorin e QKKM ta emërojë Shefi i Agjencisë.

Enis Kervan – propozoi të plotësohet amendamenti 8, në nënpikën 4, të nenit 10, të shtohet edhe një përfaqësues nga Agjencioni për Mërgatën e Kosovës i cili duhet të jetë përfaqësues nga komuniteti jo shumicë. Ky propozim u miratuan nga komisioni.

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, pas shqyrtimit të Projektligjit për Mërgatën e Kosovës, si Komision përgjegjës dhe referues miratoi amendamentet me shumicë votash “**për**” dhe të njëjtat për shqyrtim të mëtejme ia dërgon Komisioneve kryesore, dhe nxori këtë:

REKOMANDIM

Amendamenti 1

Neni 5. paragrafi 1. në reshtin e dytë fjala :”Agjencia” zëvendësohet me fjalën: “**Agjencinë**”.

Amendamenti 2

Neni 6. paragrafi 1, pika 1, në rreshtin e parë fshihen fjalët ‘ dhe monitoron ’ , teksti në vazhdim mbetet i njëjtë.

Amendamenti 3

Neni 6. paragrafi 1, pika 6, riformulohet, si vijon:” Për përmirësimin e pozitës së Mërgatës bashkëpunon me Institucionet e shteteve tjera me miratimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës”.

Amendamenti 4

Neni 7. paragrafi 1, riformulohet, si vijon: ” Agjencia udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv i cili është përgjegjës për administrimin, funksionimin dhe menaxhimin e Agjencisë”.

Amendamenti 5

Neni 7. paragrafi 3, në rreshtin e tretë fjala “relevante” zëvendësohen me fjalën : “përkatëse”.

Amendamenti 6

Neni 9. paragrafi 1, pika 1, në rreshtin e dytë fjalët : ‘të Kosovës’ zëvendësohen me fjalët : “për Kosovën”.

Amendamenti 7

Neni 9. paragrafi 1, pika 5, në rreshtin e katërt fshihen fjalët: “si dhe”.

Amendamenti 8

Neni 10. paragrafi 1, riformulohet, si vijon: “ Drejtori i QKKM zgjidhet me konkurs nga Komisioni i emëruar në përbërje prej pesë anëtarëve” si vijon: .

1. një përfaqësues nga Komisioni Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë Rini dhe Sport.
2. një përfaqësues nga ZKM .
3. një përfaqësues nga Ministria për Punë të Jashtme
4. dy përfaqësues nga Agjencioni për Mërgatën e Kosovës prej të cilit njëri përfaqësues të jetë nga komuniteti jo shumicë.

Amendamenti 9

Neni 12. paragrafi 6, pika 4, në rreshtin e parë fjalët: “librin e kurrikulit shkollor” zëvendësohen me fjalët : “tekstet shkollore”.

Vërejtje teknike

Teksti i projektligjit në gjuhën angleze dhe serbe të harmonizohet dhe unifikohet me tekstin e gjuhës shqipe.

Enis Kervan, kërkoi sqarim nga komisioni lidhur me nenin 12, paragrafi 6,1, se ky paragraf përshkruan vetëm për shpërndarjen e librave në gjuhën shqipe dhe serbe apo të të gjitha gjuhëve që fliten në Kosovë. Ai nuk pajtohet që ky paragraf të mbetet si në Projektligj, më pas theksoi se këtë çështje do ta ngrit në Komisionin për Minoritete dhe Kthim.

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, konstatoi se gjuhë zyrtare është edhe gjuha turke.

Mbledhja përfundoi në orën 12.20.

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryesuesja e Komisionit

Drita Kadriu